



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Pritmjen/Prodato Received/Delivery	18.05.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPRMBASHK	2450/2021		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.254/2021

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.254/2021 të datës 06.04.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rruga "Ahmet Gashi"-Mati I, blloku I, hyrja I, kati I-rë, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 18.05.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.254/2021 e datës 06.04.2021 e parashtruar nga ankuesi**

**A r s y e t i m**

Ndaj ankuesit i punësuar në Policinë e Kosovës sipas kontratës me numër reference:0355 të datës 24.10.2011 i njëjti ka qenë i emëruar në pozitën "Shef i Sektorit për paisje dhe pjesë rezervë, në Stacioni/Njësia: Flota Operative në Prishtinë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë", pas zhvillimit të procedurave disiplinore dhe atyre për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Policisë së Kosovës, me datë 22.06.2017 ka nxjerr vendimin Nr: 143-KA-D/2017 duke i shqiptuar masën disiplinore "Largim nga pozita komanduese apo largim në një pozitë tjetër me përgjegjësi me të ultë menaxhuuese por pa e humbur gradën dhe kategorinë funksionale" me masën plotësuese "Transfer Administrativ".

U.D Drejtori i Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës, për zbatim të vendimit të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Policisë së Kosovës të datës 22.06.2017 me Nr: 143-KA-D/2017, ka nxjerr urdhëresë me datë 13.09.2017 për zbatimin e vendimit në fjalë me të cilin është



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruar nga palët, ka konstatuar se ankesa A.nr.254/2021 e datës 06.04.2021, të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ është e *pabazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se organi punëdhënës Policia e Kosovës i ka shkelur të drejtat e tij të punës të garantuara me dispozitat ligjore në fuqi për shkak të mos aprovimit të kërkesës për kthimin në pozitën paraprake pas skadimit të afatit për transfer që nga data 15.09.2019

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, ka konstatuar se U.D Drejtori i Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës me datë 13.09.2017 ka nxjerrë urdhëresë për shqiptimin e masës disiplinore- transfer administrativ për periudhën kohore prej datës 15.09.2017 deri me datë 14.09.2019 nga pozita "Shef i Sektorit për Paisje dhe Pjesë Rezervë" në pozitën " Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Analiza" me qëllim të zbatimit të vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Policisë së Kosovës i datës 22.06.2017 me Nr: 143-KA-D/2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 50 paragrafi 1 i cili përcakton se: "*Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës*", dhe nenin 81 paragrafi 2 nen paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili ka qenë i aplikueshëm deri me datë 09.07.2020, vlerëson se çdo nëpunës civil ka pas të drejtën të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, me të cilin pretendon se i janë cenuar të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 127 ka përcaktuar se: "*paragrafi 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; paragrafi 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ*", andaj ankuesit afati i heshtjes ka filluar t'i rrjedh prej datës 15.09.2019 momentin kur edhe ka përfunduar periudha e transferit sipas vendimit U.D Drejtori i Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës të datës 13.09.2017, pasi që organi i punësimit nuk ka ndërmarr asnjë hap për kthimin në pozitën paraprake, nga rrjedh se kërkesat e ankuesit e datës 22.02.2021 dhe ajo e datës 15.03.2021 të parashtruar në kuadër të organit të punësimit-Policisë së Kosovës, janë parashtruar në kundërshtim me afatet kohore siç është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht neni 127 paragrafi 4 dhe si e tillë është e pabazuar, ndërlidhur me këtë edhe ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill është në kundërshtim me ligjin material.

Po ashtu, duke u bazuar në praktikën vendimmarrëse si dhe bazën e të dhënave të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, rezulton se ankuesi \_\_\_\_\_ me datë 21.07.2017 ka parashtruar ankesë në Këshill kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Policisë së Kosovës të datës 22.06.2017 me Nr: 143-KA-D/2017 mbi bazën e të cilit pastaj është nxjerrë edhe urdhëresa për transfer e datës 13.09.2017 nga U.D Drejtori i Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës, ankesë e cila është refuzuar me rastin e nxjerrjes së vendimit të Këshillit me numër A/02/417/2017 të datës 18.09.2017. Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Këshillit me numër A/02/417/2017 të datës 18.09.2017 me të cilin ishte refuzuar ankesa e ankuesit dhe ishte në lënë në fuqi vendimin i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe



Ankesave i Policisë së Kosovës të datës 22.06.2017 me Nr: 143-KA-D/2017, ka ngritur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa me datë 21.01.2020 Gjykata Themelore në Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative ka nxjerrë aktvendimin numër A.nr.1786/2017 dhe njëherit e ka pezulluar procedurën pasi që paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor ka theksuar se tërhiqet nga padia e datës 24.10.2017 meqenëse s'ka interes juridik për çështjen.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.254/2021

**Flakron GASHI**

  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankues
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Policisë së Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;